

ETIKA E BIZNESIT

TREGU DHE ETIKA

MODULI 4

- ***Tregu i Konkurencës së Përkryer***
 - *Moraliteti në tregjet e konkurencës së përkryer.*
- ***Tregjet në konkurrencën monopol***
 - *Konkurenca Monopol. Drejtësia, Dobia dhe të Drejtat*
- ***Tregjet e konkurencës oligopol***
 - *Marrëveshjet e hapura (eksplicite)*
 - *Marrveshjet e heshtura (implicite) dhe rryshfeti*
- ***Tregu dhe korrupsioni***

1. Hyrje

- zhvillimi i tregjeve të lira justifikohet në aspektin etik nga fakti që:
- caktojnë drejt burimet dhe shpërndajnë drejt edhe mallrat e produktet
- këto tregje maksimizojnë dobinë ekonomike të anëtarëve të shoqërisë dhe respektojnë lirinë e zgjedhjes në treg midis shitësve dhe blerësve.
- Aspektet morale të këtij sistemi të tregut varen shumë nga natyra konkurruese e vetë sistemit.

1. Hyrje

- Kur sipërmarrjet bashkohen me njëra tjetrën dhe e përdorin fuqinë e tyre për të fiksuar çmimet, ato:
 - mënjanojne konkurentët me praktika të padrejta, dhe
 - tregu nuk mund të konsiderohet më konkures
- Rrjedhojat:
 - padrejtësia,
 - përkeqësimi i dobisë sociale dhe
 - kufizimi i lirisë së zgjedhjes të individëve.
- (nevoja e vendosjes dhe e mbrojtjes së konkurrencës)

1. Hyrje

- **Cështë konkurenca dhe si lidhet ajo me etikën?.**
 - Në kuptimin *intuitiv* - konkurenca është një rivalitet midis dy ose më shumë pjesëve, që cilat përpiqen të arrijnë diçka të cilën e zotëron vetëm njëra prej tyre.
- **Tri modelet abstrakte që shprehin nivelin e konkurrencës në një treg:**
- **a) konkurenca e përkryer apo perfekte;**
- **b) monopoli; dhe**
- **c) oligopoli**

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- Cështë tregu?
- Një **grupim njerëzish** që synojnë:
- *shkëmbimin e pronësisë të produkteve, shërbimeve ose të parave.*
 - i vogël e i përkohshëm apo edhe
 - i madh dhe relativisht i qëndrueshëm.

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- Treg i konkurrencës së përkryer - tregu ku si shitësi ashtu edhe blerësi nuk kanë fuqi të ndikojnë mbi çmimet e mallrave dhe të shërbimeve.
- tiparet e tkp:
 - (1) Në treg veprojnë **një numër i madh** shitësish e blerësish, ku asnjëri nuk zotëron ndonjë pjesë të konsiderueshme të tregut.
 - (2) Të gjithë shitësit dhe blerësit **hyjnë e dalin lirisht** në treg.
 - (3) Çdo shitës e blerës ka **informacion të plotë** për atë çka bëjnë shitësit dhe blerësit e tjerë, përfshirë informacionet për çmimet, sasi të dhe për cilësinë e mallrave e të shërbimeve që janë shitur apo blerë.

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- (4) **Produktet** dhe shërbimet që shiten në treg janë të **ngjashme** me njëri-tjetrin, aq sa nuk ka rëndësi se tek cili shitës blihen.
- (5) **Kostot** dhe përfitimet e prodhimit apo të përdorimit të produkteve dhe të shërbimeve varen krejtësisht nga ata që i shesin e i blejnë ato dhe **jo nga forca të tjera të jashtëme**.
- (6) Të gjithë shitësit dhe blerësit synojnë të **maksimizojnë dobinë**, ata synojnë të marrin përfitime maksimale, kundrejt shpenzimeve sa më të ulëta.
- (7) Asnjë nga forcat e jashtme (siç është pushteti i organizmave qeveritare) **nuk mund të rregullojë çmimet**, sasinë ose cilësinë e produkteve e të shërbimeve të shitura e të blera në treg.

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- Tiparet (1) dhe (2) - karakteristika bazë të një tregu konkures - pasi garantojnë që blerësit e shitësit janë pothuaj të barabartë përsa i përket fuqisë me të cilën ato ndikojnë tek njëri tjetri.
- Tipari i fundit (7) e kualifikon tregun si treg të lirë, d.m.th. të lirë nga imponimet e rregullimeve të jashtme mbi sasinë, çmimin dhe cilësinë.

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- Për të funksionuar tkp. ka nevojë për:
- *një sistem te pronës private* (përndryshe as blerësit dhe as shitësit nuk do të kishin të drejta pronësie që do t`i përdornin për t`i shkëmbyer);
- *një sistem kontratash* (të cilat i lejojnë shitësit e blerësit të përpunojnë marrëveshjet që transferojnë pronësinë);
- *një sistem prodhimi* (i cili gjeneron produktet e shërbimet, pronësia e të cilave do të shkëmbehet).

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- Në një treg të lirë të konkurrencës të përkryer (TLKP):
- **kur ka mungesë mallrash çmimi**, që blerësit janë të gatshëm të paguajnë për mallrat e shërbimet, **rritet** (ekziston një sasi e vogël e këtyre mallrave) dhe për më tepër, kjo rritje e *çmimit i nxit shitësit që të shtojnë ofertën* (të ofrojnë sasira më të mëdha mallrash e shërbimesh).
- **kur ka tepëri mallrash e produktesh** (ekziston një sasi e madhe produktesh e shërbimesh), **çmimet tentojnë të ulen** dhe ky fakt i detyron *shitësit të pakësojnë ofertën e tyre* (të ofrojnë në treg sasira më të vogla mallrash e shërbimesh).

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- Pra, ne TLKP çmimi e sasia lëvizin drejt të ashtuquajturës “pikë ekuilibri”.
- Pika e ekuilibrit - pika në të cilën sasia e mallrave që blerësit duan të blejnë barazohet saktësisht me sasinë e mallrave që shitësit duan të shesin.
- Në këtë pikë:
 - **çmimi më i lartë**, që blerësit janë të gatshëm të paguajnë, barazohet saktësisht me
 - **çmimin më të ulët** që shitësit janë të gatshëm të pranojnë për mallrat e shërbimet e tyre.

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- Në pikën e ekuilibrit **çdo shitës gjen një blerës dhe çdo blerës gjen një shitës.**
- Ky rezultat i TLKP ka edhe një përfundim tjetër të rëndësishëm - kënaq tri kriteret bazë morale;
- (1) ***të drejtësisë,***
- (2) ***të dobishmërisë dhe***
- (3) ***të drejtës.***
- Ky lloj tregu arrin një lloj drejtësie që kënaq një version të dobishmërisë dhe respekton disa lloje të drejtash morale.

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- **Moraliteti i TLKP.**
- Tregjet e konkurrencës duke tentuar drejt të ashtuquajturës “*pikë ekuilibri*”, bëjnë të mundur të arrihen tri vlerat morale të mëposhtëme:
- udhëheqin shitësit e blerësit **në shkëmbimin reciprok të mallrave të tyre në një mënyrë që është krejtësisht e drejtë;**
- **maksimizojnë dobinë** e blerësit dhe të shitësit duke i udhëhequr ata drejt caktimit, përdorimit dhe shpërndarjes së mallrave të tyre në mënyrë eficiente;
- i realizojnë këto arritje **duke respektuar të drejtat e blerësit dhe të shitësit.**

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- **i) Për të kuptuar pse TKP i detyrojnë shitësit dhe blerësit të realizojnë shkëmbime krejtësisht të drejta** duhet të kuptojmë *nocionin kapitalist të drejtësisë*:
 - përfitimet dhe detyrimet (taksat apo ngarkesat fiskale) shpërndahen drejtësisht, kur çdo person merr vlerën e saktë të kontributit të dhënë.
- **në pikën e ekuilibrit TLKP shitësi dhe blerësi arrijnë të marrin vlerën e duhur të kontributit të dhënë prej secilit prej tyre.**

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer




Fig. 1 : Kurba e kërkesës dhe ofertës për një mall në konkurrencën të përkryer

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- (1) kurba e kërkesës tregon vlerën që konsumatori u vendos mallrave bazuar në nivelin e tyre të konsumit
- *në qoftë se çmimi rritet mbi kurbën e kërkesës, konsumatori në mënyrë të padrejtë i paguan shitësit më tepër se sa ai mendon se vlen ky mall.*
- *Në qoftë se çmimi bie nën kurbën e kërkesës, përsëri padrejtësisht konsumatori i paguan shitësit me pak sesa vlera reale që malli ka për konsumatorin.*
- Pra, nga këndvështrimi i konsumatorit, çmimi është i drejtë, vetëm në qoftë se ai bie diku në kurbën e kërkesës së konsumatorit.

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- **(2) kurba e ofertës tregon vlerësimin e shitësit për mallrat, kostot e prodhimit të këtyre mallrave në nivele të ndryshme të prodhimit.**
- Për pasojë, në qoftë se *çmimet bien nën kurbën e ofertës së shitësit*, konsumatorët ***padrejtësisht paguajnë më pak*** se sa i ka kushtuar shitësit prodhimi i mallrave.
- Në qoftë se *çmimi rritet mbi kurbën e ofertës*, atëhere shitësi ***padrejtësisht u ngarkon konsumatorëve më tepër*** se sa i ka kushtuar atij prodhimi i mallit.
- *Pra nga këndvështrimi i shitësit çmimi është i drejtë vetëm në qoftë se ai bie diku në kurbën e ofertës së shitësit.*

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- Pika e ekuilibrit është ajo dhe vetëm ajo në të cilën çmimet konsiderohen të drejta sipas pikëpamjeve që kanë për vlerën e mallrave qoftë konsumatori ashtu edhe shitësi.
- Kur çmimet dhe sasi të devijojnë nga pika e ekuilibrit shitësi ose blerësi janë të padrejtë: njëri ose tjetri duhet të paguajë më tepër sesa vlen në të vërtetë një mall.

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- Si konkluzion TLKP vendos një drejtësi të përkryer kapitaliste për pjesëmarrësit
- Pjesëmarrësit - shesin e të blejnë në sasira dhe me çmime ku cdonjëri merr sipas kontributit

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- ii) TKP, synojnë të maksimizojnë dobinë e blerësit dhe të shitësit duke i orientuar ata drejt caktimit, përdorimit dhe shpërndarjes së të mirave materiale në mënyrë eficiente.
- (a) Sistemi i TKP i motivon sipërmarrjet që t'i investojnë burimet e tyre në ato sektorë të ekonomisë ku kërkesa e konsumatorëve është e lartë dhe t'i largojnë burimet nga ato sektorë ku kërkesa është e ulët.
 - Sistemi i TKP i alokon burimet në mënyrë eficiente, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e konsumatorit: konsumatori në këtë rast është mbret.

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- (b) Tregjet e konkurrencës të përkryer i inkurajojnë sipërmarrjet të minimizojnë **sasinë e burimeve të përdorura për prodhimin e të mirave**, dhe të përdorin teknologji sa më efçente.
 - Motivimi për kursimin e burimeve, uljen e kostos dhe rritjen e fitimet marxhinale.
 - TLKP inkurajon një përdorim **efçent të burimeve të shitësit**.

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- (c) TLKP shpërndajnë mallrat tek blerësit në mënyrë të tillë që këta të fundit të mbeten sa më të kënaqur nga këto mallra, për të cilat ata paguajnë.
- presupozohet se në këtë treg, të gjithë konsumatorët blejnë mallrat që u duhen me të njëjtat çmime.
- Pra, tregjet e konkurrencës të përkryer mundësojnë konsumatorët të arrijnë një nivel të caktuar kënaqësie dhe në këtë mënyrë, bëhet e mundur, një shpërndarje efiçente e të mirave materiale.

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- **iii). TKP, duke respektuar të drejtat negative të blerësve dhe shitësve, vendosin drejtësinë kapitaliste dhe maksimizojnë dobinë.**
 - Shitësi dhe blerësi janë të lirë të hyjnë apo të dalin nga ky treg (bazuar në zgjedhjen e tyre të lirë).

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- ***Së pari***, TKP mishëron të drejtën negative të lirisë së mundësisë.
- blerësit dhe *shitësit janë të lirë të hyjnë e të dalin nga tregu*, d.m.th. asnjëri nuk detyrohet apo pengohet që të angazhohet në një biznes të caktuar përderisa ai zotëron burimet e duhura financiare.

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- *Së dyti TLKP mishëron të drejtën negative të lirisë së pëlqimit.*
- *shkëmbimet e transaksionet janë krejtësisht vullnetare, d.m.th.*
 - **pjesëmarrësit nuk detyrohen** t'u shesin apo t'u blejnë të tjerëve,
 - ata zotërojnë informacionet e duhura për tregun.
 - Asnjë forcë apo agjenci e jashtëme nuk i detyron shitësit e blerësit që të shesin e të blejnë mallrat e tyre me çmime dhe në sasia që atyre nuk u duken të përshtatshme.
 - kostot dhe përfitimet e gjeneruara nga prodhimi apo përdorimi i të mirave lindin krejtësisht nga shitja dhe blerja e këtyre të mirave dhe jo nga palët e jashtme të tregut.

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- ***Së treti*** TKP mishërojnë të drejtat negative të lirisë ndaj detyrimit.
 - *asnjë shitës apo blerës i vetëm nuk është në gjendje të dominojë tregun.*
 - fuqia industriale deçentralizohet midis shumë sipërmarrjeve, kështu që çmimet dhe sasisë nuk varen nga tekcat e një ose disa bizneseve.

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- Pra TKP janë të moralshëm në këto tri drejtime kryesore:
- Ato në mënyrë të përkryer e të vazhdueshme vendosin një formë drejtësie kapitaliste;
- Maksimizojnë dobinë në formën e efijencës së tregut;
- Respektojnë disa të drejta negative të rëndësishme të shitësit e të blerësit.

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- Dizavantazhet:
- ***Së pari***, TKP nuk vendosin forma të tjera drejtësie, përveç asaj kapitaliste.
 - nuk u përgjigjen nevojave të atyre që ndodhen jashtë tregut
 - nuk **e bazojnë drejtësinë që vendosin tek nevojat.**
 - nuk imponojnë kufizime në masën e mirëqënies pra, injorojnë drejtësinë **egalitariste (të barazisë) dhe nxitin pabarazinë.**

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- ***Së dyti***, TKP maksimizojnë ***dobinë e pjesëmarrësve në treg***, në bazë të kufizimeve që paraqet buxheti i çdo pjesëmarrësi.
 - kjo nuk do të thotë se domosdoshmërisht do të maksimizohet dobia totale e shoqërisë.
 - Të mirat që i shpërndahen çdo individ varet nga aftësitë e individit për të marrë pjesë në treg dhe nga shuma që çdo individ është i gatshëm të shpenzojë.
 - *kjo mënyrë shpërndarje e të mirave, nuk jep kënaqësinë maksimale për çdonjërin në shoqëri.*

2. Modeli i tregut të konkurrencës së përkryer

- **Së treti**, megjithëse TKP garantojnë *disa të drejta negative për pjesëmarrësit e tregut, ato mund të zvogëlojnë të drejtat pozitive të atyre që nuk marrin pjesë ose të atyre, pjesëmarrja e të cilëve është minimale.*
 - Megjithëse TKP garantojnë *drejtësinë kapitaliste, maksimizojnë dobinë ekonomike dhe respektojnë disa të drejta negative, ato i sigurojnë këto vetëm për ata që kanë mjetet dhe mundësitë (paratë apo mallrat) për të marrë pjesë në këto tregje dhe injorojnë nevojat, dobinë dhe të drejtat e atyre që nuk marrin pjesë në treg.*
- Pavarësisht nga kjo, duhet thënë se tregje të pastra të konkurrencës të përkryer zor se mund të gjenden, ndaj tregjet reale nuk janë në gjendje të arrijnë tre vlerat morale që karakterizojnë konkurrencën të përkryer.

3. Tregjet në konkurrencën monopol (TKM)

- Ne TKM nuk arrihet që të plotësohen dy nga karakteristikat e TKLKP (1) dhe (2):
- **Së pari**, në vend të një numri të madh shitësish e blerësish, ku asnjëri prej tyre nuk e zotëron tregun, - *ekziston një shitës i vetëm që e zotëron atë në masën njëqind për qind.*
- **Së dyti**, në vend të një tregu ku *hyrja e dalja është e lirë*, TKM vendos *barriera të ndryshme qoftë për të hyrë në treg ashtu edhe për të dalë nga tregu.*
 - ligjet e patentave
 - kostot e larta të kapitalizimit,
- *tregje monopol janë ato tregje në të cilët ekziston një shitës i vetëm dhe ku hyrja e shitësve të rinj kufizohet në mënyra të ndryshme.*
- shitësi që përcakton politikën e çmimit të mallrave në treg.

3. Tregjet në konkurrencën monopol (TKM)

- Sipërmarrja monopol e fikson **output-in e saj në një sasi më të vogël se pika e ekuilibrit**, ku kërkesa është aq e madhe sa që e lejon sipërmarrjen të realizojë fitime të larta duke vendosur çmime më të larta se çmimi i ekuilibrit.

3. Tregjet në konkurrencën monopol (TKM)

- Tregu monopol nuk është në gjendje që të arrijë të tri vlerat që karakterizojnë TKP.
- Shkaku kryesor - mbajtja e çmimeve të larta të cilat, për të arritur fitime të larta, dhunojnë (cënojnë) *drejtësinë kapitaliste*.
 - *çmimet janë më të larta se çmimi ekuilibër dhe*
 - *sasitë më të ulëta se ajo ekuilibër.*
- *çmimet e larta të cilat i vendos shitësi janë te padrejta, ndaj dhe fitimet e tij që rrjedhin prej këtyre çmimeve janë të padrejta.*

3. Tregjet në konkurrencën monopol (TKM)

- TKM karakterizohet nga një efijencë në rënie e shpërndarjes së të mirave sepse:
- **Së pari**, - burimet përdoren në mënyrë të atillë që në *treg të shkaktohet mungesë për mallin që konsumatori dëshiron*, - cka do të çojë në *vendosjen e çmimeve më të larta*.
- **Së dyti**, - nuk i *inkurajon ofruesit (shitësit) që të përdorin burimet për të reduktuar kostot*, ndaj dhe sipërmarrjet nuk motivohen që të gjejnë metoda të reja prodhimi me kosto të ulët.
- **Së treti**, tregjet monopol i lejojnë shitësit që të vendosin çmime të diferencuara.

3. Tregjet në konkurrencën monopol (TKM)

- Tregjet monopol, **kufizojnë të drejtat negative që i respekton tregu i konkurrencës të përkryer.**
 - pengon hyrësit e rinj;
 - lejon sipërmarrjet që t'u imponojnë blerësve mallra të cilat ata nuk i duan dhe në sasira që atyre mund të mos u duken të përshtatshme; dhe
 - dominohet nga një shitës i vetëm i cili cakton çmimet dhe sasinë e mallrave e të shërbimeve.

3. Tregjet në konkurrencën monopol (TKM)




Fig. 5.2. Kurba e kerkesës dhe ofertës për një mall në një konkurrencë monopol

4. Tregjet e Konkurencës Oligopol (TKO)

- Tregjet oligopol qëndrojnë midis dy ekstremeve:
- konkurencës të përkryer dhe
- monopolit.
- Edhe këtu, dy nga shtatë tiparet e konkurencës të përkryer nuk përmbushen.

4. Tregjet e Konkurencës Oligopol (TKO)

- **Së pari**, kemi të bëjmë *me një numër të kufizuar e të rëndësishëm shitësish*,
 - *tregu ndahet ndërmjet një numri të vogël sipërmarrjesh të mëdha, të cilat së bashku mund të influencojnë mbi çmimet..*
- **Së dyti**, shitësit e tjerë nuk e kanë të lehtë të hyjnë lirshëm në treg
 - Kostot e larta për nisjen e biznesit.

4. Tregjet e Konkurencës Oligopol (TKO)

- Menaxherët e oligopoleve e kanë të lehtë të bashkojnë forcat e të veprojnë si një njësi e vetme.
- marrëveshje të hapura apo të nënkuptuara për vendosjen e çmimeve në të njëjtin nivel dhe për kufizimin e output-it të tyre,
- tregjet oligopol, ashtu sikurse edhe ato monopol
 - Cojnë ***në përfitime të drejta,***
 - ***gjenerojnë një rënie të dobisë sociale dhe***
 - ***tentojnë drejt mosrespektimit të lirive ekonomike bazë.***

4. Tregjet e Konkurencës Oligopol (TKO)

- **Marrëveshjet e hapura (eksplicite)**
- Çmimet përcaktohen nëpërmjet *marrëveshjeve eksplicite që kufizojnë konkurrencën.*
- *Fiksimi i çmimi*
- *Manipulimi i ofertës* – kufizimi i sasisë së produktit të prodhuar me qëllim që të rriten çmimet.
- *Marrëveshjet tregëtare të ekskluzivitetit* - blerësve ju shiten produkte me kushte të tilla që këta të fundit të mos blejnë produkte nga shitësa të tjerë.
- *Marrëveshjet e kushtëzuara (të lidhura)* - kur një blerësi i shitet një mall të caktuar me kushtin që ai të bierë dakord të blejë mallra të tjera.

4. Tregjet e Konkurencës Oligopol (TKO)

- *Mbajtja e një niveli të njëjtë të çmimit të shitjes me pakicë* – kushti që shitesit zinxhir të mbajnë të njëjtin nivel çmimi të shitjes me pakicë
- *Diskriminimi në çmim* - blerësve të ndryshëm ju ngarkohen çmime të ndryshme për të njëjtat produkte apo shërbime që ata ofrojnë.

4. Tregjet e Konkurencës Oligopol (TKO)

- “Çfarë i bën, dhe pse bizneset angazhohen herëpashere në praktika të tilla jo-konkurrese?”
- *disa sektorë të ekonomisë dhe disa faktorë të tjerë organizativë kanë prirje të orientojnë drejt fiksimit të çmimit.*

4. Tregjet e Konkurencës Oligopol (TKO)

- *Një treg i maturuar* - hyrja në treg të një numri të madh sipërmarrjesh të reja dhe uljen të ardhurat e sipërmarrjeve bën që të rritet presioni mbi nivelin e mesëm të menaxhimit, nivel i cili si kundërpërgjigje bën që të lejohen, inkurajohen dhe urdhërohen ekipet e shitjes që të zbatojnë politika të fiksimit të çmimeve.
- *Natyra e urdhrave të punës të biznesit* – Kur porosive ju vendosen çmimet në mënyrë individuale, duke bërë që vendimet, të cilat merren për të caktuar çmimet, të bëhen të shpeshta dhe të realizohen nga nivele të ulëta të organizatës, atehere ka të ngjarë që të lindin marrëveshje të fshehta brendapërbrenda vetë personelit të shitjes.

4. Tregjet e Konkurencës Oligopol (TKO)

- *Produkte të padiferencuara* –
 - Ngajshmëria e produkteve të hedhura ne treg
 - Stimulon fiksime cmimeve në marrëveshje me konkurentët si e vetmja mënyre për të ruajtur sasiste dhe çmimet nga rënia.

4. Tregjet e Konkurencës Oligopol (TKO)

- *Kultura e biznesit* –
- fiksimi i çmimit është një praktikë e zakonshme, e dëshirueshme, e pranuar, racionale dhe e inkurajuar nga vetë organizata,
- menaxherët e nivelit të lartë duhet që të kundërvihen nëpërmjet shembujve të tyre personale, nëpërmjet komunikimeve të vazhdueshme të praktikave etike dhe nëpërmjet zhvillimit e përpunimit të një kodi të etikës,

4. Tregjet e Konkurencës Oligopol (TKO)

- *Praktikat e personelit* –
- Kur menaxherët vlerësohen e shpërblehen në bazë të përfitimit të arritur dhe/apo të vëllimit të punës së kryer, duke bërë që bonuset, komisionet dhe shpërblimet e tjera të varen nga këto objektiva, ata do të besojnë se kompania kërkon prej tyre arritjen e këtyre objektivave, pavarësisht nga mjetet apo mënyrat që do të përdoren.
- Kompensimi në të vërtetë duhet që të bazohet në faktorë të tjerë dhe organizata duhet të përpiqet të induktojë tek punonjesit e saj një krenari profesionale në lidhje me devotshmërinë që duhet të tregojë kompania ndaj etikës.

4. Tregjet e Konkurencës Oligopol (TKO)

- *Vendimet e përcaktimit të çmimeve* –
- organizatat me një shkallë të madhe decentralizimi, ku vendimet për përcaktimin e çmimeve lihen në duart e një pjesë të vogël të organizatës, ka shumë të ngjarë të perfshihen në fiksimin e çmimit.
- Vendimet për çmimet duhet të merren nga nivelet e larta të organizatës.

- *Stafi ligjor i korporatës* –
- Personeli që është përgjegjës për çështjet juridiko-ligjore duhet të sigurojë training të vazhdueshëm në lidhje me aspektet ligjore që lidhen me fiksimin e çmimeve, për atë personel që merret me vendosjen e çmimeve dhe me zbatimin e vendimeve të shitjes.

5. Tregu dhe korrupsioni

- Tregu dhe korrupsioni
- Korrupsioni, - *përdorimi dhe shfrytëzimi i pushtetit (autoritetit) për të marrë përfitime private.*
- *Rryshfeti përfaqëson një pagesë jo-ligjore ose nxitje të tjera që kryhen për përfitime private.*
- Karakteristika me e dukshme të korrupsionit, - një mjet me të cilin korruptuesit korruptojnë zyrtarët

5. Tregu dhe korrupsioni

- Korrupsioni zhvillohet në shumë forma dhe gjithnjë mbahet sekret
- sjellja individuale e zyrtarëve të korrumpuar është pothuajse e pamundur të vëzhgohet në mënyrë sistematike në jetën reale.
- **Efektet**
 - (1) **rënia e efikasitetit ekonomik;**
 - (2) **padrejtësitë sociale,** e deri tek
 - (3) **paqëndrueshmëria politike.**
- Studimet ekonometrike tregojnë se në kushtet kur treguesit mbeten të pandryshuar, ***rritja e korrupsionit shoqërohet me pakësim të rritjes ekonomike.***

5. Tregu dhe korrupsioni

- Më përdorimit të zakonshëm, korrupsioni përfshin:
- *rryshfetin,*
- *rrëmbimi me anën e forcës,*
- *mashtrimi,*
- *nepotizmi,*
- *mitën,*
- *përvetësimin,*
- *falsifikimi i regjistrimeve,*
- *influencimet, etj.*
- *Korrupsioni, përtej faktit të konsiderimit të tij si një çështje politike, perceptohet si barriera kryesore për investimet dhe për drejtësinë sociale.*
- Transparenca e dobët dhe mungesa e llogaridhënies së administratës publike kanë krijuar shtratin pjellor mbi të cilin lind dhe zhvillohet korrupsioni.

5. Tregu dhe korrupsioni

- Atje ku ka **kombinime të pozitës monopol me lirinë e veprimit të zyrtarëve si edhe me kërkesa të ulëta llogaridhënie, ekziston mundësia të shfaqet dhe të lulëzojë korrupsioni.**
- Nga ana tjetër, atje ***ku zyrtarët publikë paguhen pak dhe mungon vlerësimi i performancës, atje ku ndëshkimet ndaj shfaqeve të korrupsionit janë të rralla dhe të paqarta, ekzistojnë kushtet që ai të lulëzojë.***
- Një zyrtar publik mund të përfshihet në korrupsion atëherë kur shuma e të ardhurave të siguruara nga korrupsioni është më e madhe se gjoba që do të aplikohet ndaj tij (ndëshkimi) në rast se korrupsioni do të mund të zbulohet. Ndëshkimi përfshin pagën si dhe të tjera humbje të mundëshme që duhet të sakrifikojë zyrtari në se ai humb punën, përfshirë këtu edhe ashpërsinë e ndëshkimit penal.
- Edhe mundësia për t`u zbuluar ka një probabilitet, i cili sa më i ulët të jetë, aq më shumë rritet mundësia e përfshirjes në korrupsion.

5. Tregu dhe korrupsioni

- Madhësia e përfitimit të zyrtarëve nëpërmjet korrupsionit është në funksion të
- (1) shkallës së monopolit mbi një shërbim ose aktivitet të caktuar të,
- (2) shkallës së liri-veprimit për të vendosur se kush duhet ta kryejë shërbimin dhe me çfarë çmimi, si edhe të
- (3) shkallës së përgjegjshmërisë (llogaridhënies) për këtë veprimtari.

- Në mënyrë simbolike kjo do të shprehej me formulën e mëposhtëme:
- **C = M + D – A**, ku
- **C** - Niveli i korrupsionit
- **M** - Pozita monopol
- **D** - Shkalla e liri-veprimit të zyrtarëve publike
- **A** - Përgjegjshmëria (Llogaridhënia)
-

5. Tregu dhe korrupsioni

- Në të tilla kondita, luftës kundër korrupsionit do t`i ndihmonte heqja e pozitës monopol, qartësimi i mënyrës së veprimit (përshkrime të qarta të funksioneve administrative – clear job discriptions) të zyrtarëve publikë, kontrolli i autorizimit të veprimeve, si edhe rritja e kërkesës për më shumë përgjegjshmëri e llogaridhënie.
- Përvetësimi i mjeteve publike për përfitime private dhe përdorimi për këtë qëllim i fondeve publike nga politikanët dhe zyrtarët e nivelit të lartë ka ndikime të qarta dhe të drejtëpërdrejta në frenimin e zhvillimit ekonomik.
- Analizat e rryshfetit që u paguhet zyrtarëve publike prej biznesit privat dhe në veçanti, ndikimi i tij (rryshfetit) në sektorin privat janë shumë komplekse.